



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0443

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) TONI O.P., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me aparat fotografik me numër të prokurimit 207-26-2057-1-3-6, me 03/08/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërishte e bazuar ankesa e OE TONI O.P. me nr. 2026/0443 , e datës 29/06/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me aparat fotografik me numër të prokurimit 207-26-2057-1-3-6.
2. Anulohet, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, ndërkaj aktiviteti i prokurimit Furnizim me aparat fotografik me numër të prokurimit 207-26-2057-1-3-6, kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik TONI O.P.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 07.04.2026 MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Ftesën për ofertim, për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me aparat fotografik" me nr. të prokurimit: "207-26-2057-1-3-6"

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë me kuotim të çmimit, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 6,960.00 €.

Me 10.06.2026. MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Infinit”SHPK”.

Me 15.06.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 26.06.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 29.06.2026, OE “TONI O.P. ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0443, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “TONI O.P.” janë parashtruar si në vijim:

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjit Nr. 05/L-092, Shkeljet në këto nene:

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr.002/2024 për Prokurimin Publik

Në mbështetje të nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ne operatori ekonomik "TONI O.P.", në cilësinë e palës me interes material, parashtrojmë këtë ankesë kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 10.06.2026 dhe Vendimit mbi Kërkesën për Ri-shqyrtim të datës 26.06.2026, si palë e pakenaqrur me ri-vlersimin e ofertave i paraqesim faktet dhe argumentet tona:

Pretendimi ankimor 1: Bazuar në ofertën tonë të paraqitur, arsyeja e dhënë për eliminimin tonë nuk qëndron. Kjo për faktin se ne kemi dorëzuar ofertë administrativisht të përgjegjshme dhe me çmimin më të ulët. Gjithashtu, kemi dëshmuar përvojën e kërkuar duke ofruar së paku dy furnizime të ngjashme të natyrës së njëjtë. Furnizimet/kontratat për Muzeun Kombëtar të Kosovës (nr. rendor 14) dhe Galerinë Kombëtare të Kosovës (nr. rendor 21), ku kemi realizuar furnizim me pajisje të ngjashme, të cilat janë në përputhje me natyrën e këtij aktiviteti, për të cilin ne jehti eliminuar pa të drejtë dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik dhe Rregulloret përkatëse.

Ne kemi ofruar edhe një letër sqaruese në lidhje me kontratat e përfunduara dhe referencat e tyre, por Komisioni i Vlerësimit nuk i ka marrë fare parasysh; të njëjtat nuk janë shqyrtuar aspak dhe, në kundërshtim me LPP-në, nuk është arritur vlerësimi mbi bazën e Parimeve të Prokurimit Publik.

Edhe në këtë ankesë po ju sqarojmë Ekspertit Shqyrtues dhe PSH me fakte dhe argumente:

Referencën e ngjashme mund ta gjeni në listën e kontratave me numër rendor 14, me titull: "Furnizim me pajisje pune dhe materiale të nevojshme për restaurim konservimin e artefakteve dhe kabineteve për Muzeun Kombëtar të Kosovës Ritenderim i dytë", me numër të prokurimit: 207-24-1004-1-2-5, të dëshmuara përmes kontratës dhe referencës së bashkangjitur. Ndërsa në kontratë sipas paramasës artikulli ngjashëm gjendet me numër rendor 16.

Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues është dashur që, në përputhje me nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së, ta vlerësojë ofertën tonë në mënyrë objektive, ashtu se ka vlerësuar ofertën e operatorit të rekomanduar për kontratë.

Në arsyetimin e dhënë në Vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues e ka arsyetuar vendimin e tij si vijon:

Ne si Operator Ekonomik, këtë arsyetim e kundërshtojmë me faktin se Raporti i pranimi i Komisionit qartëson se ne si OE, kemi përfunduar kontratën 100%, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, që do të thotë se edhe produkti "aparati fotografik" është furnizuar si pjesë e kontratës (shih dëshmitë e bashkangjitura).

Kontratat tona janë vlerësuar në mënyrë selektive, ndërsa te operatori i rekomanduar "PATTERN SH.P.K.", bazuar në qasjen në dokumente, lista e kontratave nuk përmban furnizime të ngjashme sipas titujve me furnizimin e fotoaparateve. Kjo dëshmon se oferta jonë është eliminuar pikërisht për shkak të këtij perceptimi të gabuar nga komisioni, ndërkohë që ndaj operatorit me ofertë më të shtrenjtë është aplikuar një standard tjetër, duke e rekomanduar atë për kontratë.

Vlerësimi duhet të bëhet objektivisht dhe jo kontratat të perceptohen sipas titujve si natyrë tjetër, por të bëhet një vlerësim sa më racional, ku kontratat të vlerësohen në mënyrë substanciale, dhe jo në interpretime të cekëta apo formale.

Po ashtu edhe kontrata tjetër e listuar me numër rendor 21, me titull "Furnizim me pajisje dhe materiale për mbarëvajtjen e aktiviteteve kulturore për Galerinë Kombëtare të Kosovës" me nr prokurimi: 207-24-10608-1-2-1, nuk është shqyrtuar fare, ndërkohë që edhe në këtë kontratë kemi furnizuar produkte të natyrës së ngjashme (shih dëshmitë e bashkangjitura).

Pretendimi ankimor 2: Në bazë të letrës standarde, në arsyet e eliminimit të sonë është cekur se:

ARSYETIM

Fillimisht thuhet se ne nuk kemi kontrata të natyrës së ngjashme, më pas është kërkuar sqarim shtesë. Pas sqarimeve të ofruara, komisioni ka konfirmuar se kemi realizuar kontrata të ngjashme, por është pretenduar se nuk kemi arritur të dëshmojmë pranimin e produkteve nga komisioni i pranimit.

Ky arsyetim është në kundërshtim të hapur me gjendjen faktike dhe kontradikt me vetëveten, pasi ne kemi ngarkuar dokumentacionin e pranimit të të gjitha produkteve nga komisioni i pranimit, duke dëshmuar përfundimin e kontratës sipas kushteve të kontrates dhe brenda afatit të paraparë.

Gjithashtu gjatë rivlerësimit ndaj nesh si operator ekonomik "TONI O.P." është aplikuar standard i dyfishtë, përkundër faktit se jemi operator i përgjegjshëm dhe ekonomikisht më i favorshëm, me ofertën më të ulët.

AK me publikimin e Formularit B58 - Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, keni shkelur dispozitat ligjore, përkatësisht nenet 1, 6, 7, 59 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 40 të Rregullores nr. 001/2022 (të amendamentuar), pasi që ka refuzuar ofertën tonë me çmimin më të ulët dhe të përgjegjshme, si dhe:

AK nuk ka siguruar shfrytëzim efikas dhe ekonomik të fondeve publike, duke eliminuar ofertën me çmimin më të ulët pa bazë të qëndrueshme.

Mungesë transparence në arsyetimin e vendimit dhe mosshqyrtim i sqarimeve tona.

Vlerësim subjektiv dhe jo substancial i kontratave dhe referencave.

Pretendimi ankimor 3: Në bazë të qasjes në dokumentet e OE "PATTERN SH.P.K.", vërehen mangësi në ofertë, të cilat e bëjnë atë të papërgjegjshme administrativisht. Në Deklaratën nën Betim është hequr preambula "header", dhe si rrjedhojë nuk është e qartë se për cilën procedurë është lëshuar deklarata. Shih dëshmitë:

*Si duhet të jetë:

SI është deklarata, dhe është larguar preambula, e cila është e vendosur në dosjem e tenderit.

Duke marrë parasysh të gjitha pretendimet tona të bazuara në fakte dhe argumente, kërkojmë nga ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT, që të marrë:

VENDIM

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e OE: "TONI" O.P. Lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me aparat fotografik" me nr. të prokurimit: 207-26-2057-1-3-6 dhe Nr i brendshëm: 207-26-020-1-3-6,

II. ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit të lartëcekur dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

Pergjigje ne kerkesen per rishqyrtim:

Lidhur me procedurën e prokurimit: Furnizim me aparat fotografik, me numër të prokurimit 207-26-2057-1-3-6.

Pretendimi 1

Refuzohet pretendimi ankimor si pjesërisht i pabazuar:

Duke marrë parasysh se dokumenti në fjalë nuk përmban ndryshime substanciale që do të ndikonin në vlefshmërinë e tij, prandaj i njëjti konsiderohet dokument valid.

Pretendimi 2

Refuzohet pretendimi ankimor si i pabazuar:

ATK-ja është në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues dhe, njëkohësisht, është lëshuar brenda afateve ligjore të përcaktuara.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 30.06.2026. ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0443 ndërsa me datë 10.07.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0443, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e “TONI O.P.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0443 ka vlerësuar si në vijim:

Aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me aparat fotografik” me nr. të prokurimit: "207-26-2057-1-3-6", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, procedurë me kuotim të çmimit, lloji i kontratës: furnizim, kriteri: çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së, i cili ka rekomanduar për kontratë OE Infinitt SHPK, ndërsa OE ankuesin eliminon me arsyetimin:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Operatori Ekonomik “TONI O.P Kërvasari 24000, Malishevë, Kosovë” ka ofertuar me çmimin: 5300 E. Pas vlerësimit të ofertës është konstatuar se OE nuk e ka plotësuar kriterin me nr. 1 të kapacitetit teknik dhe profesional të paraqitur nga AK në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. OE ka ofruar Listën e kontratave të realizuara por në listë nuk ka kontrata të natyrës së ngjashme andaj oferta refuzohet si ofertë administrativisht e papërgjegjshme.

Tutje, OE ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, i njëjti parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se vlerësimi i ofertave është bërë në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) përkatësisht nenet: 1,6,7,59,72 dhe nenin 40 të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022 / 002/2024.

Pretendimi i parë i OE ankues

OE ankues pretendon se AK pa të drejtë ka eliminuar të njëjtin, për faktin se posedon minimum dy kontrata të ngjashme të renduara me nmër 14 dhe 21, dhe se refuzimi nga AK nuk qëndron.

Përgjigje në pretendimin ankimor

Ekspertja shqyryuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, AK në dosje të tenderit ka kërkuar:

Kërkesa numër 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme ne tri vitet e fundit të përfunduara deri në publikimin e njoftimit për kontratë (Formularit B05).

Dëshmia e kërkuar:

1. Lista e projekteve të ngjashme për tri vitet e shkuara, e vulosur dhe e nënshkruar nga OE, minimum sa vlera e planifikim nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, të ofrojë dëshmi për realizimin e kontratave, bashkangjitur referencat si dëshmi të lëshuara nga kontraktuesi

Rrjedhimisht, në ofertën e OE ankues gjendet lista e projekteve që përfshin natyra të ndryshme, si punë, shërbim dhe furnizim. Duke marrë parasysh kërkesën e AK-së në DT, ku është kërkuar kontrata të natyrës së ngjashme, dhe duke i krahasuar me titujt e projekteve të ofruara nga OE ankues, rezulton se nuk ka asnjë furnizim specifik të natyrës së njëjtë. Megjithatë, meqë kërkesa në DT është e natyrës së ngjashme, si procedurë me kuotim çmimi, me të vetmen kërkesë projektet e ngjashme dhe kriter çmimi më i ulët i përgjegjshëm, atëherë sipas përshkrimit të projektit me numër rendor 14, i cili është furnizim me pajisje pune, në të cilin sipas dëshmive të OE ankues në paramasë përfshihet edhe furnizimi me aparat profesional me dy lente, ashtu siç kërkohet në specifikat teknike në DT, ku ankuesi ka ofruar dëshminë e faturës për blerjen e aparatit Nikon me të njëjtat specifika teknike si në paramasën e projektit, artikull i renditur me numër 16. Andaj, AK rekomandohet të respektojë nenet 1, 6, 7 dhe 52.7 të LPP-së. Pretendimi i OE ankues rezulton i qëndrueshëm.

Meqë projekti i përfunduar në fjalë, është për të njëjtin Autoritet Kontraktues, atëherë AK në rivlerësim mund të analizoj dhe hulumtoj konform nenit 52.7 të LPP-së.

Pretendimi i dytë i OE ankues

OE ankues pretendon se edhe OE i rekomanduar për kontratë OE Pattern SHPK, nuk përmbanë furnizime të ngjashme, ndërsa rekomandon të njëjtin për kontratë.

Përgjigje në pretendimin ankimor

Lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues, ekspertja shqyrtuese sqaron se, operatori ekonomik i potencuar në pretendim Pattern SHPK, është operator i eliminuar nga AK, lidhur me mos përmbushje të kërkesës për projekte të ngjashme, andaj pretendimi i OE ankues nuk qëndron. Për faktin se OE i rekomanduar për kontratë është OE Infinitt SHPK .

Pretendimi i tretë

OE Pattern SHPK nuk ka plotësuar sakt deklaratën nën betim.

Përgjigje në pretendimin ankimor

Ekspertja shqyrtuese sqaron se, OE Pattern SHPK është i eliminuar nga AK, OE i rekomanduar për kontratë është OE Infinitt SHPK. Pretendim i paqëndrueshëm, Për faktin se OE i rekomanduar për kontratë është OE Infinitt SHPK i cili posedon deklaratën nën betim sipas kërkesës.

Si përfundim, bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit, kriterit çmimi më I ulët I përgjegjshëm, rekomandohet që aktiviteti I prokurimit të kthehet në rivlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me aparat fotografik” me nr. të prokurimit: "207-26-2057-1-3-6".

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovet si pjesërisht e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se në raportin e ekspertizës sa i përket pretendimit ankimor lidhur me eliminim e OE ankues në mungesë të dëshmive mbi furnizimet e ngjashme siç është kërkuar për PSH është i pranueshëm konstatimi i eksperti shqyrtues, po ashtu për çka edhe ka eliminuar OE ankues ku mungon titulli i kontratës në listën e kontratave, të njëjtën mungesë e ka edhe OE i rekomanduar nga AK-ja , ndërsa lidhur me konstatimin në raportin e ekspertizës ku ka cituar “ *Ekspertja shqyrtuese sqaron se, OE Pattern SHPK është i eliminuar nga AK, OE i rekomanduar për kontratë është OE Infinitt SHPK. Pretendim i paqëndrueshëm, Për faktin se OE i rekomanduar për kontratë është OE Infinitt SHPK i cili posedon deklaratën nën betim sipas kërkesës*”, PSH konstaton se pas kthimit të rivlerësimit nga AK-ja është shpërblyer OE Patent SH.P.K, dhe për PSH pavarësisht që OE në fjalë ka fshirë titullin e kontratës, në Deklaratën nën Betim prap mbetet Deklarata nën Betim me gjitha të dhënat e nënshkruar dhe e vulosur dhe mund të konsiderohet si një devijim minimal.

Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues bazuar në nenin 1,6 dhe 7 të LPP-së e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që aktiviteti të kthehet në rivlersim , mirëpo ankesën e OE ankues e aprovohen si pjesërisht të bazuar, dhe vendos të anulohet B58 Njoftim mbi vendimin e AK-se, lënda të kthehet në rivlerësim, duke kërkuar nga AK-ja që gjatë rivlerësimit ti përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së..

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nënpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- **OE - TONI O.P.**
- Arkivës së OSHP-së: